

GJYKATA E APELIT

Numri i lëndës: PAKR 347/13

Data: 18 Gusht 2015

GJYKATA E APELIT TË KOSOVËS, në përbërje të panelit nga gjyqtari i EULEX-it Roman Raab si kryetar i trupit gjykues dhe gjyqtar raportues, dhe anëtar të trupit gjykues të gjykatës së apelit të Kosovës, gjyqtaret Fillim Skoro dhe Abdullah Ahmeti, me pjesëmarrjen e Anne-Gaëlle Denier, zyrtare ligjore e EULEX-it, si procesmbajtëse,

Në procedure penale kundër:

N.D., emri i babait [], emri i nënës dhe i vajzërisë [],[], në paraburgim nga data 25 Maj 2011 deri më 2 qershor 2011;

A.S., emri i babait [], emri i nënës dhe i vajzërisë [] në paraburgim nga data 25 Maj 2011 deri më 2 qershor 2011;

N.P., emri i babait [], emri i nënës dhe i vajzërisë [], në paraburgim nga data 25 Maj 2011 deri më 2 qershor 2011;

B.S., nofka [], emri i babait [], emri i nënës dhe i vajzërisë [], në paraburgim nga data 25 Maj 2011 deri më 2 qershor 2011;

K.H., nofka [], emri i babait [], emri i nënës dhe i vajzërisë [], në paraburgim nga data 25 Maj 2011 deri më 2 qershor 2011;

Të akuzuar sipas aktakuzës të PSRK-se, PPS 70/10 të datës 30 nëntor 2011, e modifikuar me 16 shkurt 2012 si në vijim:

- Pika 1: **Shpërdorim i detyrës zyrtare apo autoritetit**, në shkelje të nenit 339(1) të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (në tekstin vijues si “KPPK-se”), në fuqi që nga data 6 Prill 2004 deri më 31 Dhjetor 2012)
- Pika2: **Marrja e ryshfetit**, në shkelje të nenit 343(1) KPPK-se

Dhe kundër:

H.F., emri i babait [], emri i nënës dhe i vajzërisë [];

Të akuzuar sipas aktakuzës të PSRK-se, PPS 70/10 të datës 30 nëntor 2011, e modifikuar me 16 shkurt 2012 si në vijim

- Pika 1: **Shpërdorim i detyrës zyrtare apo autoritetit**, në shkelje të nenit 339(1) të KPPK-se;

I gjykuar në shkallen e pare nga gjykata themelore e Mitrovicës me aktgjykim P. nr. 22/12 të datës 15 shkurt 2013 si në vijim:

- Të pandehurit **N.D., B.S.** dhe **K.H.** të shfajësuar nga veprat penale të *shpërdorimit të detyrës zyrtare apo autoritetit*, në shkelje të nenit 339(1) të KPPK-se dhe *Marrja e ryshfetit*, në shkelje të nenit 343(1) KPPK-se;
- I pandehuri **H.F.** i shfajësuar nga vepra penale e *shpërdorimit të detyrës zyrtare apo autoritetit*, në shkelje të nenit 339(1) të KPPK-se
- I pandehuri **N.P.** i shpallur fajtor për veprat penale të *shpërdorimit të detyrës zyrtare apo autoritetit*, në shkelje të nenit 339(1) të KPPK-se dhe *marrja e ryshfetit*, në shkelje të nenit 343(1) KPPK-së dhe i dënuar me një dënim unik prej një (1) viti dhe dy (2) muaj burgim, dënimi i pezulluar për periudhën verifikuese prej dy vitesh dhe gjashte muaj;
- I pandehuri **A.S.** i shpallur fajtor për veprat penale të *shpërdorimit të detyrës zyrtare apo autoritetit*, në shkelje të nenit 339(1) të KPPK-se, i dënuar me pese (5) muaj burgim, dënimi i pezulluar për periudhën verifikuese prej dy vitesh dhe i shfajësuar për veprën penale të *marrjes së ryshfetit*, në shkelje të nenit 343(1) KPPK-së;

Duke vendosur në baze të ankesave vijuese, të ushtruara kundër aktgjykimit të gjykatës themelore të Mitrovicës, P. nr. 22/12 të datës 15 shkurt 21013

- **Ankesa e prokurorit special, e ushtruar më 26 Prill 2013**
- **Ankesa e avokatit mbrojtës Zeqir Maxhuni në emër te të pandehurit N.P., e ushtruar më 26 Prill 2013**
- **Ankesa e avokatit mbrojtës Rexhep Kaçaniku në emër te të pandehurit A.S., e ushtruar më 7 Maj 2013**

Pas shqyrtimit të parashtrësës të prokuroritë apelit të shtetit të ushtruar me 10 shtator 2013;

Pas mbajtjes se seancës më 18 Gusht 2015;

Pas këshillim –votimit të mbajtur më 18 gusht 2015;

Në pajtim me nenet 389, 390, 394, 398 dhe 401 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (në tekstin vijues “KPP-së”);

Nxjerr si në vijim

AKTGJYKIM

- I. Nëpërmjet kësaj refuzohet si e pabazuar ankesa e avokatit mbrojtës Zeqir Maxhuni në emër të të pandehurit N.P.;
- II. Nëpërmjet kësaj refuzohet si e pabazuar ankesa e avokatit mbrojtës Rexhep Kaçaniku në emër të të pandehurit A.S.;
- III. Nëpërmjet kësaj refuzohet si e pabazuar ankesa e Prokurorit Special;
- IV. Nëpërmjet kësaj konfirmohet aktgjykimi i gjykatës themelore të Mitrovicës P. nr. 22/12 i datës 15 shkurt 2013;

ARSYETIMI

I. HISTORIKU I RËNDËSISHËM PROCEDURAL

Të pandehurit akuzohen me ngjarjet vijuese: në mes të verës së vitit 2010 dhe Majit 2011, **N.D., A.S., N.P., B.S., K.H.** dhe **H.F.**, pjesëtar të Policisë së Kosovës në rajonin e Mitrovicës, duke vepruar në cilësinë e tyre, dhe me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë materiale me pretendim kane shpërdorur detyrën e tyre zyrtare duke ofruar ndihme dhe/apo informata dëshmitarit bashkëpunues A.H. ashtu që ai mund të kontrabandonte mallra në pikat kontrolluese policore të krijuara në mes të pjesës veriore dhe jugore të Mitrovicës, pavarësisht mungesës së lejes apo autorizimit për tregti, dhe me pretendim kane marr të holla si shkëmbim.

Më 30 nëntor 2011 Prokurori Special i Republikës së Kosovës ka ushtruar aktakuzën SPRK. nr. PPS 70/10 kundër të pandehurve të lartcekur për veprat penale të krimit të organizuar në pajtim me nenin 274 (2) të KPPK-se, kontrabandimi i mallrave në pajtim me nenin 273 (1) të KPP-se, shpërdorim të detyrës zyrtare apo autoritetit në pajtim me nenin 339 (1) të KPPK-se dhe marrja të ryshfetit në pajtim me nenin 343 (1) të KPPK-se.

Shqyrtimi kryesor në këtë rast është mbajtur më 30 dhe 31 Janar, dhe më 1, 4, 5, 7, 8, 11 dhe 12 shkurt 2013 dhe dispozitivi i aktgjykimit është shpallur më 15 shkurt 2013. Aktgjykimi me shkrim është hartuar më 25 Mars 2013.

Më 26 Prill 2013 dhe 7 Maj 2013 avokati mbrojtës Zeqir Maxhuni në emër të **N.P.** dhe avokati mbrojtës Rexhep Kaçaniku në emër të **A.S.t**, kane ushtruar ankesën kundër aktgjykimit kundërshtues. Prokurori Special nuk ka ushtruar ndonjë përgjigje.

Më 26 Prill 2013 prokurori Special po ashtu ushtroi ankesën kundër aktgjykimit.

Më 16 Maj 2013, avokati mbrojtës Vehbi Beqiri në emër të **B.S.t** me 15 Maj 2013, avokati mbrojtës Zeqir Maxhuni në emër të **N.P.**, me 20 Maj 2013, avokati mbrojtës Bashkim Mehana në emër të **K.H.t** me 14 Maj 2013, avokati mbrojtës Faruk Korenica në emër të **N.D.** përkatësisht ushtruan përgjigjet kundër ankesës së Prokurorit Special.

Rasti është transferuar në gjykatën e apelit për vendim mbi ankesat e datës 9 shtator 2013.

Më 10 shtator 2013 Prokurori shtetëror i apelit ka ushtruar mocioni.

Seanca e kolegjit të gjykatës së apelit është mbajtur më 18 gusht 2015. Pasi që asnjë dënim me burgim nuk është shqiptuar në shkallen e parë, palëve nuk iu është dorëzuar njoftimi mbi seancën në pajtim me nenin 390 (1) të KPP-se.

Kolegji i apelit është këshilluar dhe ka votuar më 18 gusht 2015.

II. PARASHTRESAT E PALËVE

A. Ankesa e N.P.

Avokati mbrojtës Zeqir Maxhuni më 26 Prill 2013 ka ushtruar një ankesë në gjykatën themelore në emër të të pandehurit **N.P.** në të gjitha bazat. Ai e ankimon aktvendimin e gjykatës themelore mbi pranueshmërinë e provave të datës 6 shkurt 2013 (në tekstin vijues ‘aktvendimi mbi pranueshmërinë e provave’) duke debatuar shkelje të nenit 384 (1.8) të KPP-se. Në veçanti ai rikujton se mbrojtja tani më e ka kundërshtuar lidhur më këtë gjatë shqyrtimit kryesor dhe ka treguar se provat ishin të pa pranueshme duke ditur se në baze të dy neneve 91 (3.1) të KPP-se dhe nenit 256 (3) të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës (në tekstin vijues ‘KPPK-se’), monitorimi i fshehtë i bisedave mund të kryhet vetëm nga zyrtari i autorizuar gjyqësor policor identiteti i të cilit sigurohet, e në këtë rast nuk ishte kështu.

Lidhur më vërtetimin të gabuar dhe jo të plote të fakteve, avokati mbrojtës debaton se gjykata themelore ka dështuar që të vlerësoj në mënyrë të duhur provat të dëshmitarit bashkëpunues A.H.. Sipas tij, provat demonstronjë se i pandehuri **N.P.** e ka njohur familjen e A.H. për një kohe të gjatë dhe se ai pranoi 15 € nga dëshmitari si shpagese për derivate pasi që ai e ka shfrytëzuar makinën e të pandehurit.

Lidhur më çështjet të cekura në aktgjykim se i pandehuri do duhej të vepronte si një shembull pozitiv për shkak të detyrës së tij zyrtare, avokati mbrojtës i drejtohet faktit se gjykata themelore ka shpërfillur provat relevante që konstatojnë se i pandehuri i ka kryer detyrat e tij më zell dhe profesionalisht, posaçërisht **N.P.** ka pranuar letër mirënjohëse nga komandanti policor për arritjet e tija.

Për të gjitha këto arsye, avokati mbrojtës kërkon nga gjykata e apelit që të modifikoj aktgjykimin duke e liruar **N.P.** apo të anuloj aktgjykimin dhe të ktheje rastin në gjykatën themelore për rigjykim.

B. Ankesa e A.S.t

Avokati mbrojtës Rexhep Kaçaniku më 7 Maj 2013 ka ushtruar ankesën në gjykatën themelore në emër të të pandehurit **A.S.** mbi bazat si më poshtë:

- Shkelje substanciale të dispozitave të procedurës penale
- Shkelje të Kodit Penal
- Vërtetimi i gabuar dhe jo i plote i gjendjes faktike
- Gabimi në vendimin e sanksioneve penale

Lidhur me **shkelje të dispozitave të procedurës penale**, avokati mbrojtës paraqet se gjykata themelore nuk e ka gjykuar plotësisht substancën e akuzës, në shkelje të nenit 384 (1.7) të KPP-se, dhe ka dështuar që të siguroj përshkrimin e fakteve që kanë shpër në dënimin e tij për shpërdorim të detyrës zyrtare apo autoritetit.

Lidhur me **shkelje të Kodit Penal**, avokati mbrojtës debaton se i pandehuri **A.S.** nuk ishte në pozite që të kryej ndonjë detyre specifike, kontrabandim të paligjshëm të mallrave të drejtuar nga A.H. duke ditur se ai nuk ishte i caktuar në njësinë e patrullimit të policisë së Kosovës që ishin përgjegjës në kontrollimin e makinave për transportim të paligjshëm të mallrave. Si të tilla i pandehuri nuk ka mundur të ndaloj dëshmitarin bashkëpunues dhe të kontrolloj makinën e tij. Prandaj, veprimet e tija nuk mund të karakterizojnë veprën penale të shpërdorimit të detyrës zyrtare apo autoritetit në nenin 339 (1) të KPPK-se.

Lidhur me **vërtetimin e gabuar dhe jo të plote të fakteve**, avokati mbrojtës debaton se gjykata themelore ka gabuar në interpretimin e dëshmisë së dëshmitarit bashkëpunues A.H. dhe në gjetjen e saj si të besueshme. Ai po ashtu flet për mospërputhjet të pretenduara në dëshminë e dëshmitarit S.E. sa i përket pajisjeve.

Përfundimisht, sa i përket **vendimin mbi sanksionet penale**, avokati mbrojtës debaton se dënimi i burgimit më kusht nuk mund të qëndroj.

Për këto arsye, avokati mbrojtës kërkon nga gjykata e apelit që të prish aktgjykimin e kundërshtuar dhe të e kthej rastin në rigjykim

C. Ankesa e Prokurorit Special

Prokurori Special Besim Kelmendi më 26 Prill 2013 ka ushtruar ankesën në gjykatën themelore në baze të:

- Gabimi në vendimin mbi sanksionet penale kundër pjesës dënuese të aktgjykimit;

Dhe, kundër pjesës shfajësuese të aktgjykimit dhe vendimin mbi pranueshmërinë e provave në baze të:

- Shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale
- Vërtetimit të gabuar dhe jo të plote të gjendjes faktike
- Shkelje të Kodit Penal

Në veçanti, prokurori special debaton se gjykata themelore ka gabuar pasi që dispozitivi i aktgjykimit është i paqarte dhe në kundërshtim më veten e tij dhe nuk specifikon se cili dënim është pezulluar dhe nuk specifikon kushtet për revokim të dënimit më kushte në pajtim më nenin 45 të KPPK-se. Ai në vazhdim debaton se dënimi i shqiptuar është shume i ulet dhe se gjykata themelore ka dështuar të vlerësoj si duhet rrethanat renduese dhe lehtësuese. Në veçanti, prokurori special parqet se në prani të këtyre rrethanave renduese dhe në mungese të ndonjë rrethane relevante lehtësuese, nuk ishte e arsyeshme për gjykatën themelore që të shqiptoj dënimin më kushte për të pandehurit **A.S.** dhe **N.P.**

Për këto arsye, prokurori special propozon që gjykata e apeli të modifikoj pjesën e dënimit të aktgjykimit dhe ti shqiptoj dënimin më të lart kundër të pandehurve më dënim efektiv më burgim.

Duke u kthyer në pjesën shfajësues të aktgjykimit, prokurori special debaton se gjykata themelore ka gabuar në mos sigurimin të ndonjë sqarimi rreth asaj se perse deklaratat e **N.D.**, **B.S.**, **K.H.** dhe **H.F.t.** të pandehurit që janë liruar, nuk janë konsideruar si provat në pajtim më nenin 231 (2), (5) të KPPK-se. Sipas mendimit të tij, gjykata themelore nuk ka vërtetuar plotësisht dhe në mënyre korrekte faktet të rastit dhe ka shpërfillur këto deklarata, të kombinuara më deklaratat e dëshmitarit bashkëpunues, që përbëjnë dy pjesë të provave të vërtetuara që do të ishin të mjaftueshme që të fajësohen të pandehurit të liruar.

Lidhur më aktvendimin mbi pranueshmërinë e provave, prokurori special debaton se gjykata themelore ka gabuar kur i ka gjetur video dhe audio materialet si të papranueshme që nga momenti kur procesverbali është marr, urdhrat për masat të tilla të fshehta tani më ishin të lëshuara kundër të pandehurve të tjerë. Deri sa prokurori special njofton se nuk ka pasur asnjë urdher për lirimin e të pandehurve, ai potencon se ata sidoqoftë, ishin zënë duke kryer veprat penale për të cilat ishin akuzuar më ane të aktakuzës dhe se kjo do duhej të konsiderohet si prove.

D. Përgjigjet në ankesën e Prokurorit Special

Më 14 Maj 2013 **avokati mbrojtës Faruk Korenica** në emër të **N.D.**, më 15 Maj 2013 **avokati mbrojtës Zeqir Maxhuni** në emër të **N.P.**, më 16 Maj 2013 **avokati mbrojtës Vehbi Beqiri** në emër të **B.S.**, deh më 20 Maj 2013 **avokati mbrojtës Bashkim Mehana** në emër të **K.H.**, përkatësisht kane ushtruar përgjigjet kundër ankesës se prokurorit special. Të gjithë debatojnë se prokurori special ka dështuar që ti mbështesë pretendimet e tija lidhur më shkelje të pretenduara të procedurës penale, të Kodit Penal, dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plote të gjendjes faktike.

Avokatet mbrojtës, të gjithë kundërshtojnë qëndrimin e prokurorit special në aktvendimin e pranueshmërisë se provave dhe debatojnë se gjykata themelore më të drejte ka gjetur se provat të cekura ishin të papranueshme, duke potencuar se nuk ka pasur urdhër për implementimin e masave të fshehta kundër të pandehurve dhe se provat për këtë arsye ishin të papranueshme. Më tej avokati mbrojtës pohon se interpretimi i prokurorit special të nenit 231 (2), (5) të KPPK-se është i gabuar. Avokati mbrojtës i **B.S.t** në veçanti potencon se i pandehuri asnjëherë nuk ka pohuar në ndonjë deklaratë faktet për të cilat ai akuzohet në aktakuze, dhe dëshmitari bashkëpunues A.H. ka ofruar prova të kundërshtueshme dhe të pabesueshme. Avokati mbrojtës për **K.H.n** po ashtu debaton se i pandehuri asnjëherë nuk ka pranuar apo konfirmuar pranë policisë apo prokurorit publik se ai ka ndërmarr veprimet për të cilat ai akuzohet. Avokati mbrojtës për **N.D.n** referohet nenit 156 (2) të KPPK-se që parasheh se deklaratat të deponuara nga i pandehuri në polici apo pranë prokurorit publik mund të përdoren që të ankimohen deklaratat e të pandehurit në gjykate, dhe në nenin 157 (2) të KPPK-se që parasheh se i pandehuri nuk mund të shpallet fajtor vetëm në baze të deklaratave të deponuara pranë policisë apo prokurorit publik.

Ata të gjithë i propozojnë gjykatës se apelit që të hedhin poshtë si të pabazuar ankese e ushtruar nga prokurori special dhe të konfirmojnë aktgjykim kundërshtues.

E. Parashtrësia e Prokurorit Special të apelit

Prokurori i shtetit Sabri Ademi më 10 Shtator 2013 ka ushtruar mocionin duke kërkuar që gjykata e apelit të refuzoj si të pabazuar ankesat në emër të të pandehurve **A.S.** dhe **N.P.**, dhe të miratoj si mire të bazuar ankesën e prokurorit special ashtu që të modifikoj aktgjykimin kundërshtues, të shqiptoj dënimin më të lartë kundër **A.S.t** dhe **N.P.**, të anuloj pjese e shfajësimin të aktgjyimit dhe të riktheje rastin në rigjykim, apo të ti gjeje të pandehurit e shfajësuar fajtor për veprat penale që ata akuzoheshin. Prokurori shtetëror mbështet dhe ri përsërit argumentet që janë paraqitur në ankese të Prokurorit Special. Ai në veçanti shtone se gjykata themelore ka gabuar në gjetjen e provave si të papranueshme në aktvendimin mbi pranueshmërinë e provave, pasi që në atë kohe masat ishin kryer, urdhri për masat të fshehta lidhur më të pandehurit të tjerë

tani më kane ekzistuar, dhe përmes këtyre masave veprimet fajësuese tani më janë zbuluar. Prokurori shtetëror debaton se përgjigjet të ushtruara në emër të **K.H.t**, **B.S.t**, **N.P.t** dhe **N.D.t** janë të pabazuara dhe duhet të shpërfillen nga gjykata e apelit.

III. GJETJET E KOLEGJIT TË APELIT

A. Kompetenca e panelit

Në pajtim me nenin 472 (1) KPP-se kolegji ka shqyrtuar kompetencën e tij. Në pajtim me Ligjin mbi gjykatat dhe Ligji mbi juridiksionin, përzgjedhja dhe caktimi i lendeve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë – Ligji nr. 03/L-053, sikurse që është modifikuar me Ligjin nr. 04/L-273 dhe sqaruar përmes marrëveshjes në mes të shefit të EULEX Kosovë dhe Këshillit gjyqësor të Kosovës me datën 18 qershor 2014, kolegji konkludon se EULEX-i ka juridiksion mbi rastin dhe se kolegji është kompetent që të vendos rastin përkatës në përbërje të dy gjyqtarëve të Kosovës apo vendor dhe një gjyqtar të EULEX-it.

B. Pranueshmëria e ankesave

Aktgjykimi kundërshtues është shpallur me 15 shkurt 2013 dhe është hartuar me 25 Mars 2013. Të gjitha ankesat janë ushtruar brenda afatit ligjor prej 15 ditëve në pajtim me nenin 380 (1) të KPP-se. Tre ankesat janë ushtruar nga personat e autorizuar dhe përmbajnë të gjitha informatat të tjera në pajtim me 376 *et seq* të KPP-se. Prandaj ato janë të pranueshme.

C. Gjetjet mbi meritat

Kolegji i apelit se pari do të shqyrtoj pjesën e aktgjykimit që ka të bëjë me ndëshkimin dhe dënimin e të pandehurve **A.S.** dhe **N.P.** dhe me pas sipas radhës do të trajtoj arsyet lidhur me ankesën e **A.S.t**, **N.P.** dhe Prokurorit Special. Së dyti kolegji do të kthehet të diskutoj sfidat të ngritura në ankesën e Prokurorit Special lidhur me shfajësimin e të pandehurve **N.D.**, **B.S.**, **K.H.**, dhe **H.F.**.

1. Pjesa bindëse dhe ndëshkuese e aktgjykimit

a. Ankesa e A.S.t

Kolegji i apelit së pari refuzoi mocionin e **A.S.t** që thoshte se gjykata themelore nuk e ka gjykuar plotësisht substancën e akuzave dhe ka dështuar që të siguroj përshkrimin e fakteve që kane shpërfillur në dënimin e tij. Për më tepër kolegji është i bindur se aktgjykimi mjaftueshëm ka gjykuar substancën e akuzës në pajtim me nenin 384 (1.7) të KPP-se dhe se faktet që kane shpërfillur në

dënimin e **A.S.t** për shpërdorim të detyrës zyrtare dhe autoritetit janë paraqitur në mënyre të duhur të plote dhe në detaje. Në veçanti kolegji vëren gjetjet e gjykatës themelore se sepse **A.S.** “ka zbuluar informatat specifike esenciale dhe të besueshme një zyrtarit që nuk ishte oficer policie”, ai tejkaloj kufizimet e funksioneve të tij¹. Gjykata themelore më tutje elaboroi në përmbajtjen specifike të këtyre instruksioneve në mënyre të hollësishme në aktgjykim, në veçanti se “ai i dha instruksione të veçanta dëshmitarit bashkëpunues lidhur më ndërrimet e tija, se në cilën pjese të ditës do të ishte më mire të transportohen mallrat, faktin që se paku tre makinat duhet të ndërrohen kur transportohen mallrat dhe ri sigurimin që ata nuk do të ndalen nëse i akuzuari do të vishte uniformen e tij”².

Lidhur më argumentin e **A.S.t** që ai nuk ishte në pozite të kryej veprën penale , pasi që i pandehuri nuk ishte i stacionuar në njësitin patrullues relevant, këtu gjykata e apelit nuk është e bindur më këtë pretendim. Kolegji në të kundërtën gjene pavarësisht nëse **A.S.** ishte fizikisht i caktuar në njësitin patrullues dhe që efektivisht ishte duke kontrolluar makinat, kjo është jo relevante duke ditur se ai ende ishte në asi pozite që ti kaloj t’ia jep A.H. informatat të rëndësishme të besueshme që ai i ka siguruar vetëm përmes pozitës se tij zyrtare si oficer policor. Kolegji rikujton se vepra penale e shpërdorimit të detyrës zyrtare apo autoritetit nenin 339 (1) të KPPK-se, kërkon që personi të tejkaloj limitin e autorizimeve të tij/saj. Gjykata e apelit gjene se kjo ishte e qarte, rasti kur **A.S.** iu ka zbuluar A.H. informatat të besueshme lidhur më ndërrimet policore dhe se vepra penale e shpërdorimit të detyrës zyrtare apo autoritetet është e kualifikuar.

Sa i përket provave të dëshmitarit bashkëpunues A.H., gjykata e apelit është e mendimit se avokati mbrojtës ka paraqitur një numër të mospërputhshmërisë se pretendimeve në dëshminë e A.H., dhe kjo nuk ka demonstruar ndonjë gabim aq sa duhet në vlerësimin e gjykatës themelore nga dëshmia e tij. Kolegji është i bindur se gjykata themelore më kujdes e ka shqyrtuar sqarimin e **A.S.t** që kontaktet e tija më A.H.n kishin qellim në marrjen e pajisjeve dhe faktit që ai ka mohuar që është pajtuar më atë lidhur më aktivitetet të kontrabandimit³. Gjykata e apelit nuk gjene gabime në gjetjet faktike të gjykatës themelore dhe në konkludimin që versioni i **A.S.t** nuk është i besueshëm në zbardhjen e provave të pakontestueshme që rezultojnë nga zbatimi i masave të fshehta që vërtetojnë llogaritë e dëshmitarit bashkëpunues A.H.⁴. Prandaj gjykata gjene se gjykata themelore nuk ka gabuar në gjetjen e dëshmisë se tij si të besueshme dhe kredibile.

Lidhur më pretendimet e mospërputhshmërisë në dëshminë e dëshmitarit S.E., kolegji i apelit vëren se gjykata themelore nuk i ka bazuar gjetjet e saj që **A.S.** i ka shitur pajisjet e tija A.H., në dëshminë e S.E.t mirëpo vetëm në transkriptet të siguruara gjate zbatimit të masave të fshehta

¹ Shiko aktgjykimin e gjykatës themelore, paragrafët 103, 110.

² Shiko aktgjykimin e gjykatës themelore, paragrafët 93, 110

³ Shiko aktgjykimin e gjykatës themelore, paragrafët 88, 92, 100

⁴ Shiko aktgjykimin e gjykatës themelore, paragrafët 101, 102.

dhe deklaratat e dëshmitarit bashkëpunues A.H.⁵. Sido qofte, kolegji ka vërejtur se gjykata themelore referohet në aktgjykim në faktin se dëshmitari S.E. e ka korrigjuar dëshminë e tij lidhur më këtë⁶.

Gjykata e apelit përfundimisht menjëherë e ka refuzuar si të pambështetur mocionin e **A.S.t** lidhur më dënimin.

b. Ankesa e N.P.

Sa i përket aktvendimin mbi pranueshmërinë e provave, dhe më në veçanti debatin e avokatit mbrojtës se identiteti i oficerit po mungon nga urdhri për masat të fshehta dhe se prova rezultuese është e papranueshme, gjykata e apelit rikujton se gjykata themelore tani më i ka adresuar këtë debat nga mbrojtja gjate shqyrtimit kryesor të mbajtur më 8 shkurt 2013⁷.

Lidhur më këtë, nuk ia vlen që raporti hetues nga Policia e Kosovës e datës 23 nëntor 2011 në baze të urdhrin të Prokurorit për zgjatje të masës se monitorimit të fshehte qarte e identifikon identitetin e policit gjyqësor të autorizuar që i ka kryer operacionet.

Kolegji është i bindur se raporti dhe urdhri për masat të fshehta janë zbatuar në pajtim më dispozitat e nenit 260 (4) të KPPK-se, dhe se procedura është respektuar plotësisht. Prandaj kolegji gjene se procesverbalet e vëzhgimit të fshehte më video të **N.P.** të datës 18 nëntor 2011 dhe transkriptet korresponduese që formuan bazën për dënimin e tij në mënyre të vlefshme janë vlerësuar si të pranueshme nga gjykata themelore e cila nuk ka gabuar në mbështetje të provave. Kolegji më tej pajtohet më vlerësimin e gjykatës themelore se masat të fshehta kundër të pandehurve **A.S.** dhe **N.P.** janë vërtetuar në mënyre të duhur dhe se prova rezultuese ishte e pranueshme.

Të kthehemi të dëshmitari bashkëpunues A.H., gjykata e apelit në kundërshtim më pohimet e mbrojtjes konsideron se gjykata themelore në mënyre të duhur e ka vlerësuar provat e tij sa i përket **N.P.** në aktgjykim. Shprehimisht vuri në dukje faktin se dëshmitari bashkëpunues, kur ka dëshmuar gjate shqyrtimit kryesor, “*plotësisht u largua*” nga deklarata e tij e datës 4 Prill 2011 dhe 20 korrik 2011 në prokurori ku ai e ka konfirmuar një marrëveshje më të pandehurin⁸. Në shqyrtim A.H. në fakt ka vërtetuar versionin e **N.P.** se të hollat e shkëmbyera ishin vetëm kompensim për derivate që ai i konsumoi kur e përdori makinën e të pandehurit dhe se nuk ka

⁵ Shiko aktgjykimin e gjykatës themelore, paragrafët 102, faqe 27.

⁶ Shiko aktgjykimin e gjykatës themelore, paragrafët 45, faqe 19

⁷ Shiko procesverbalin e shqyrtimit kryesor më 8 shkurt 2013, faqe 19 (Anglisht)

⁸ Shiko aktgjykimin e gjykatës themelore, para. 124. Krahaso deklaratën e dëshmitarit A.H., 4 Prill 2011, regjistruari i prokurorisë nr. 1, faqe 84-87 dhe procesverbali i marrjes në pyetje të dëshmitarit A.H., 20 korrik 2011, regjistruari i prokurorisë nr. 1, faqe 126, 127 më procesverbalin e shqyrtimit kryesor, 4 shkurt 2013, faqe 27, 28, 37 (Anglisht).

pasur marrëveshje në mes tyre⁹. Kolegji i apelit është i bindurës gjykata themelore morri në konsideratë këto versionet të ndryshme në vlerësimin e saj të provave. Kolegji nuk vëren ndonjë arsye që të largohet nga konsiderimi i gjykatës themelore që ndryshimi i tij radikal të dëshmisë demonstroi “një aspiratë e dëshmitarit bashkëpunuese A.H. që të mbroj të akuzuarin N.P.”¹⁰.

Gjykata e apelit më tutje nuk gjene gabime në analizat të kryera nga gjykata themelore që vlera provuese e transkriptove që rezultojnë nga zbatimi i masave të fshehta është e pakalueshme në krahasim më deklaratat e A.H. dhe N.P.¹¹. Kolegji më kujdes i ka shqyrtuar provat të paraqitura në gjykim dhe gjeti se transkriptet përbëjnë provat të pakontestueshme se N.P. ka kryer veprat penale më të cilat akuzohet. Prandaj, gjykata themelore nuk ka gabuar në mospërfilljen e dëshmisë në gjykate të A.H. lidhur më këtë.

Kolegji më kujdes ka shqyrtuar rrethanat lehtësuese të vërtetuar nga gjykata themelore dhe ankimimet të ngritura nga avokati mbrojtës për N.P. lidhur më këtë. Gjersa është e vërtet se gjykata themelore shprehimisht nuk është referuar në letrën mirënjohëse dhe certifikatën të një detyre të jashtëzakonshme të pranuar nga N.P. për detyrat e tyre profesionale kur i ka vlerësuar rrethanat lehtësuese, sidoqoftë, kolegji i apelit është i mendimit se ky aspekt është përfshirë në konsideratë ete përgjithshme që i pandehuri nuk ka pasur akuza të më hershme penale, shfaqja e sjelljes se mire në përgjithësi. Sidoqoftë, duke ditur se këto dy deklaratat të datave të kaluar të vitit 2002 dhe 2008, kolegji konsideron se janë të rëndësisë se vogël dhe vlerës provuese. Prandaj, kolegji i apelit nuk ka gjetur se gjykata themelore ka gabuar në vlerësimin e rrethanave personale të pandehurit si rrethanat lehtësuese.

Në zbardhej të asaj që është cekur më sipër, sipas mendimit të kolegjit të apelit, ekziston prove e qarte dhe e vërtetuar kundër të dy të pandehurve A.S. dhe N.P., që ata kane kryer veprat penale më të cilat akuzohen, domethënë provat të siguruar në mënyre të ligjshme nen masat të fshehta dhe prova nga dëshmitari bashkëpunues A.H.. Prandaj, kolegji gjene se gjykata themelore nuk ka gabuar në ndëshkimin e tyre.

c. Ankesa e Prokurorit Special

Lidhur më dënimin, kolegji gjene se përshkrimi i fakteve në dispozitivë të aktgjykimit është mjaft i qarte duke treguar se cili dënim është pezulluar dhe më tutje nuk gjene gabime në fakt se dispozitivi nuk specifikon kushtet për revokim të dënimit më kusht nen nenin 45 të KPPK-se duke ditur se këto kushtet tani më qarte janë të paraqitura më ligj.

⁹ Shiko aktgjykimin e gjykatës themelore, para. 124. Shiko po ashtu procesverbalin e shqyrtimit kryesor, 4 shkurt 2013, faqe 27, 28, 37 (Anglisht)

¹⁰ Shiko aktgjykimin e gjykatës themelore, para. 124.

¹¹ Shiko aktgjykimin e gjykatës themelore, para. 126.

Kur kthehemi të pretendimi i prokurorit special që dënimi i shqiptuar është shume i bute, duke ditur se rrethanat renduese të rastit dhe duke ditur mungesën e rrethanave lehtësuese ‘relevante’, kolegji vëren në të kundërtën se gjykata themelore më të drejte ka konsideruar si faktor valid lehtësues fakti që të dy të pandehurit nuk kane pasur dënimet më të hershme penale¹².

Kolegji i apelit vëren se gjykata themelore më sa duket ka marre në konsideratë faktin që të pandehurin mbanin pozitën si oficer policor si një rrethane renduese kur përcaktuan dënimin në rastin aktual. Pozita e autoritetit sidoqoftë, tani më është një element të veprës penale për të cilën **N.P.** dhe **A.S.** janë shpallur fajtor, domethënë, shpërdorim të detyrës zyrtare apo autoritetit. Tutje këto rrethanat janë shterur kur bie fjala në përcaktimin e dënimit sepse elementet e krimit tani më janë reflektuar në rangun e ndëshkimeve të veprës penale. Është një rregull e përgjithshme dhe pasoje ligjore të parimit *ne bis ne idem* apo rreziku i dyfishtë që rrethanat që përbëjnë elemente të veprës penale për të cilën i pandehuri është gjetur fajtor nuk mund të konsiderohen shtese për përcaktimin e ndëshkimit në fazën e dënimit¹³, prandaj kolegji gjene se gjykata themelore në mënyre të palejueshme dyfish e ka llogaritur një element të veprës penale si një faktor rendues.

Megjithatë, pas shqyrtimit të kujdesshëm të rrethanave të rastit dhe rrethanave renduese, dhe duke pas parasysh rregullat e përgjithshme mbi ndëshkimin të përshkruara me nenin 64 të KPPK-se, gjykata e apelit vëren se dënimet përkatëse më burgim të shqiptuara mbi **N.P.** dhe **A.S.** janë korrekte duke ditur rrethanat të rastit dhe duke ditur rangun e ndëshkimit të përshkruar më nenin 339 (1) të KPPK-se, domethënë, deri në një vjet burgim, dhe neni 343 (10) të KPPK-se, që është, ndërmjet gjashtë muajve dhe pese vite burgim. Prandaj kolegji është i bindur se gabimi i gjykatës themelore nuk ka ndikim dhe dënimi i shqiptuar ndaj dy të pandehurve është vërtetuar në mënyre të duhur nga gjykata themelore.

Gjykata e apelit rikujton që liria e gjere e veprimit të kolegjeve gjykuese janë të siguruar më vërtetimin e dënimit të duhur dhe fushëveprimin e kufizuar të rezultuar të shqyrtimit për gjykatën e apelit¹⁴. Në zbardhjen e asaj që është cekur mësipërm kolegji nuk gjene ndonjë gabim në vendimin e gjykatës themelore që të shqiptoj dënimin më kushte me burgim me periudhe të verifikimit. Kolegji gjene se kjo reflekton më një dënim të përshtatshëm në baze të rrethanave të rastit dhe është e arsyeshme dhe në pajtim më dispozitat relevante të Kodit Penal, domethënë, nenet 42 dhe 44 të KPPK-së.

Në përkufizim, kolegji i apelit refuzon si të pabazuar ankesat e **A.S.**t dhe **N.P.** në tërësinë e tyre, si dhe ankesën e prokurorit special deri tani pasi që lidhet më dënimin e **A.S.**t dhe **N.P.**. Në këtë drejtim aktgjykimi kundërshtues konfirmohet.

¹² Shiko aktgjykimin e gjykatës themelore, para. 153.

¹³ Shiko shembullin, PAKR 1122/2012, aktgjykimi, 25 Prill, para. 58

¹⁴ Shiko shembullin, PAKR 1122/2012, aktgjykimi, 25 Prill, para. 53

Kolegji tani do të kthehet të shqyrtoj nëse gjykata themelore ka gabuar në shfajësimin e të pandehurve **N.D.t**, **B.S.t**, **K.H.t** dhe **H.F.t**.

2. Pjesa shfajësuese e aktgjykimit

Kolegji rikujton se gjykata supreme ka konsideruar se pyetja nëse ekziston prova e mjaftueshme e vërtetuar dhe e prezantuar e cila duhet të vlerësohen nga rasti në rast, dhe kur të behet kjo, kolegji duhet të këtë parasysh të gjitha provat të prezantuara në rast dhe besueshmërinë e provës¹⁵. Leximi i aktgjykimit zbulon se gjykata themelore shprehimisht nuk është referuar në provën që gjendet në pjesën e pranueshme të deklaratave të procedurës paraprake të pandehurve. Gjykata e apelit gjene se gjykata themelore ka gabuar që nuk e ka konsideruar këtë prove.

Megjithatë, kolegji po ashtu rikujton se në pajtim me nenet 157 (2) të KPPK-se dhe nenin 262 (2) të KPP-se i pandehuri nuk mund të shpallet fajtor vetëm në baze të deklaratave të tij atë deponuar në polici apo pranë prokurorit publik, dhe në pajtim me nenet 157 (4) të KPPK-se dhe nenit 162 (4) KPP-se dënimi nuk mund të ndodhe vetëm në baze të provave të dëshmitarit bashkëpunues¹⁶.

Në zbardhjen e asaj që është cekur mësipërm, dhe duke ditur se në rastin aktual dëshmia kundër **N.D.t**, **B.S.t** dhe **K.H.t**, mbështetet vetëm në baze të deklaratave të tyre të procedurës paraprake, deri tani, pasi që ato janë të pranueshme, dhe dëshmia e dëshmitarit bashkëpunues A.H.; kolegji gjene se prova, edhe e kombinuar, nuk mjafton që të tërhiqet dënimi pasi që secila prove, e konsideruar veçmas, ka mungese të besueshmërisë se mjaftueshme dhe vlerës provuese në pajtim me nenet 157 (2) dhe 157 (4) të KPPK-se. Prandaj, kombinimi nuk mund të arrij pragun minimum që të përbëjë bazën për gjetjen e fajësisë kundër **N.D.t**, **B.S.t** dhe **K.H.t**.

Sidoqoftë, kolegji më kujdes ka shqyrtuar pjesën e pranueshme të deklaratave të tyre të procedurës paraprake të deponuara të prokurori special dhe është e bindur se ato përmbajnë aspak ose pak informatat lidhur më veprën penale për të cilën të pandehurit akuzoheshin¹⁷.

Gjykata e apelit kështu gjene se dështimi i gjykatës themelore duke mos konsideruar dëshminë që gjendet në deklaratat e të pandehurve të procedurës paraprake nuk ka ndikim në vlerësimin e

¹⁵ Shiko aktgjykimin e gjykatës supreme, PML. Kzz. 98/2014, 3 shtator 2014, faqe 17.

¹⁶ Kolegji është i mendimit se në kundërshtim më pretendimet e avokati mbrojtës të **N.D.**, deklarata e të pandehurit në polici apo prokurori publike në nenin 156 (2) të KPPK-se, nuk mund të përdoret e vetme që të ankimoj të pandehurin në gjykatë, mirëpo po ashtu mund të përdoret si prove e drejtpërdrejtë.

¹⁷ Shiko deklaratën e **N.D.**, 1 qershor 2011, regjistruari i prokurorisë nr. 1, procesverbali i marrjes në pyetje të **N.D.**, 12 korrik 2011, regjistruari i prokurorisë nr. 1, deklarata e **B.S.**, 3 korrik 2011. regjistruari i prokurorisë nr. 1, deklarata e **K.H.**, 3 korrik 2011, regjistruari i prokurorisë nr. 1.

gjithanshëm të fakteve dhe në vërtetimin e rezultatit të rastit. Kolegji është i bindur se gjykata themelore nuk ka gabuar në gjetjen se dëshmia e paraqitur në gjykim nuk mund të provonte përtej dyshimit të arsyeshme se **N.D.**, **B.S.**, **K.H.** dhe **H.F.** kane kryer veprat penale për të cilat akuzohen.

Sa i përket të pandehurit **H.F.t.**, kolegji i apelit rikujton se procesverbali i vëzhgimit të fshehët me video të **H.F.t** më 2 dhjetor 2010 dhe transkriptet korresponduese janë konsideruar të pranueshme nga gjykata themelore në aktvendimin mbi pranueshmërinë e provave, dhe se gjykata themelore ka gjetur se përgjimi i bisedave nuk ka zbuluar ndonjë element që do të *“vërtetonte çfarë është deklaruar nga”* A.H.¹⁸.

Kolegji pajtohet më vlerësimin e gjykatës themelore se nuk ka asgjë fajësuese në provat përgjuese të **H.F.t.** Përveç kësaj shqyrtimi i deklaratës se procedurës paraprake të **H.F.t** të datës 20 maj 2011 reflekton se nuk përmban asnjë element lidhur më veprën penale që ai akuzohej.

Sidoqoftë, gjykata e apelit vëren mospërputhje në mes deklaratës fillestare të A.H. deponuar pranë prokurorit special, ku ai thekson se **H.F.** ka siguruar informatat në pikat kontrolluese kundër kompensimit financiar¹⁹, dhe deklaratat e tij e dyte, dhe dëshmia e tij në gjykate, ku ai tregon se ata nuk kane pasur marrëveshje në mes tyre²⁰

Në çdo rast, gjykata e apelit është e bindur se nuk ka pasur provat fajësuese të paraqitura në gjykim kundër **H.F.t** dhe nuk sheh ndonjë gabim në vendim e gjykatës themelore që të e liroj atë.

Duke u kthyer përfundimisht në pretendimet e prokurorisë lidhur më aktvendimin mbi pranueshmërinë e provave, kolegji gjene që në fakt urdhrat te vlefshëm për masat të fshehta ishin më vend kundër **N.P.** dhe kjo nuk mjafton që ti bene masat të kryera ndaj **N.D.**, **K.H.** dhe **B.S.** të ligjshme dhe të nxjerr prova rezultuese të pranueshme. Duke ditur këtë asnjë urdhër nuk ishte i duhur për monitorim të fshehët të bisedave në vendet publike dhe fotografim të fshehte dhe video vëzhgim kundër këta të pandehurit të veçantë në kohen kur provat janë siguruar, kjo dëshmi duhet të konsiderohet e papranueshme në pajtim më nenin 264 (1) të KPPK-së.

Gjykata e apelit më tutje refuzon parashtresën e prokurorit që provat megjithatë duhet të konsiderohen të pranueshme duke ditur se veprimet fajësuese janë zbuluar në këtë dëshmi e cila është siguruar pa ndonjë urdhër për masat të fshehta.

Sikurse që është treguar drejte nga gjykata themelore në aktvendimin e saj mbi pranueshmërinë e provave, neni 257 të KPPK-se ku referohet faktit se urdhrat për masat të fshehta duhet të jene

¹⁸ Shiko aktgjykimin e gjykatës themelore, para. 135

¹⁹ Shiko deklaratën e dëshmitarit A.H., 4 Prill 2011, regjistruari i prokurorisë nr. 1, faqe 91, 92.

²⁰ Shiko procesverbalin e marrjes në pyetje të dëshmitarit A.H., 20 korrik 2011, regjistruari i prokurorisë nr. 1, faqe 124; procesverbali i shqyrtimit kryesor, 4 shkurt 2013, faqe 26, 27 (Anglisht).

kundër ‘personit të veçantë’, dhe neni 259 (1.1) të KPPK-se ku parasheh se urdhrat të tilla duhet të specifikojnë ‘emrat dhe adresat e subjektit apo subjektin e urdhrit’. Këto dispozitat më tej konfirmojnë se masat të fshehta duhet të shenjestronje në veçanti personat të identifikuar dhe nuk mund të zgjaten tek personat të pidentifikuar në baza të rëndomta. Përndryshe, do të përbënte shkeljen e të drejtave që të respektohet jeta private e sanksionuar nen nenin 8 të Konventës Evropiane mbi të Drejtat njerëzore. Kolegji kështu potencon rendësin fundamentale të kontrollit të rreptë dhe rregulloreve sa i përket zbatimit të masave të fshehta që janë te padëshirueshme.

Në zbardhej të asaj që është thënë gjykata e apelit refuzon si të pabazuar ankesën e prokurorit special lidhur më pjesën shfajësuese të aktgjyimit dhe në këtë drejtim konfirmon aktgjykimin kundërshtues

D. Konkludimi

Gjykata e apelit, për arsye të elaboruar mësipërm, refuzon ankesën e prokurorit special, dhe ankesat në emër të **N.P.** dhe **A.S.t** dhe në këtë drejtim konfirmon aktgjykimin kundërshtues.

E hartuar në anglisht, si gjuhe e autorizuar. Aktgjykimi i arsyetuar i kompletuar më 8 tetor 2015.

Kryetari i trupit gjykues

Roman Raab
Gjyqtar i EULEX-it

Anëtar i trupit gjykues

Fillim Skoro
Gjyqtari i gjykatës se apelit të Kosovës

Anëtar i trupit gjykues

Abdullah Ahmeti
Gjyqtari i gjykatës se apelit të Kosovës

Procesmbajtësi

Anne-Gaëlle Denier
Zyrtare ligjore e EULEX-it

GJYKATA E APELIT TË KOSOVËS
PAKR 547/14
18.08.2015